



DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

**ANALIZA E PERFORMANCËS
JANAR - QERSHOR 2020**

Tabela e Përmbajtjes:

KREU I- ARRITJET KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR - QERSHOR 2020

1. Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.....	3
2. Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 111/2017.....	4
2.1 Hartimi i akteve të brendshme vetërregulluese.....	4
3. Ndihma Juridike Parësore.....	5
3.1 Hapja e qendrave të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore.....	5
3.2 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.....	8
3.3 Autorizimi i Organizatave Jofitimrurëse për dhënien e ndihmës juridike parësore.....	9
4. Ndihma Juridike Dytësore.....	11
5. Mbajtja, mbledhja, plotësimi dhe administrimi i të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve.....	12
6. Dhënia e ndihmës juridike online.....	13
6.1 Funksionimi i platformës juristonline.....	13
6.2 Vendosja në dispozicion e numrit të gjelbër (falas) 08001010.....	14
7. Vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike.....	14
7.1 Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore.....	15
7.2 Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike dytësore.....	16
7.3 Mbikëqyrja e shërbimit të ndihmës juridike online.....	17
8. Zhvillimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut.....	18
8.1 Zhvillimi i aktiviteteve nërgjegjëse.....	18
8.2 Hapja e faqes zyrtare web të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.....	20
8.3 Promovimi i sistemit të shërbimit të ndihmës juridike falas përmes rrjeteve sociale.....	20
8.4 Promovimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore/dytësore përmes vendosjes së posterave pranë institucioneve kryesore në vend.....	21
9. Kontribute të DNJF në kuadër të raportimeve për Bashkimin Evropian.....	21
10. Angazhim i DNJF në kuadër të dokumentave strategjik.....	21
10.1 Strategjia për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.....	22
10.2 Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP).....	22
10.3 Strategjia Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND).....	22
10.4 Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 (SNKK).....	23
10.5 Strategjia për të Miturit.....	23
11. Dhënie kontributi në kuadër të raportimeve kombëtare/ndërkombëtare.....	24
12. Përcjellja e qëndrimeve mbi studimet e kryera nga organizata ndërkombëtare.....	25
13. Analiza të Drejtorisë së Ndihmës Juridike falas.....	26

KREU II- RAPORTIMI DHE MENAXHIMI FINANCIAR.....28

KREU III- PROBLEMATIKAT DHE SFIDAT PËR TË ARDHMEN.....30

Bashkëlidhur:

- *Material përmbledhës për të dhënat statistikore mbi shërbimet e ofruara të ndihmës juridike falas gjatë periudhës janar - qershor 2020. (shtojcë me totalin e të dhënave në gjuhën shqipe dhe angleze)*
- *Material përmbledhës me disa zhvillime kryesore të javës së parë të muajit korrik*

KREU I- ARRITJET KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR - QERSHOR 2020

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas¹, në cilësinë e institucionit kryesor përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, në kuadër të përmbushjes së planit 6 mujor të punës Janar-Qershor 2020, ka vijuar me kryerjen e një sërë procedurave, të cilat në mënyrë të përmbledhur parashtrohen si më poshtë vijon:

1. Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, është person juridik publik nën varësinë e Ministrit të Drejtësisë, organizimi i brendshëm i së cilës është miratuar nga Kryeministri, me Urdhër Nr. 59, datë 25.03.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë Ndhmës Juridike Falas" me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bazuar në strukturën e miratuar nga Kryeministri, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, ka në përbërje të saj drejtoritë e mëposhtme:

- *Drejtori i Përgjithshëm;*
- *Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore;*
- *Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike;*
- *Drejtoria e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse*

Që prej Nëntorit të vitit 2019, DNJF ka funksionuar me një staf të reduktuar prej 11 specialistësh, njëri prej të cilëve në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të komanduar të Drejtorisë.

Me qëllim që struktura të plotësohej me stafin e saj drejtues: (*Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas; Drejtor i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore; Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike; Drejtori i Drejtorisë së Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse*), kemi vijuar në mënyrë të përsëritur me komunikimet me Departamentin e Administratës Publike me qëllim shpalljen e vendeve vakante dhe përfundimin e procedurave të rekrutimit.

Aktualisht, me Urdhër nr. 201, datë 01.7.2020, të Ministrit të Drejtësisë është emëruar z. Ergys Qirici në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas (TND). Për tre drejtorët e drejtorive të ndihmës juridike, procedurat e rekrutimit do të rishpallen pas miratimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë të përkrahjeve të punës për secilin drejtor.

¹ Në vijim DNJF

2. Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 111/2017

Lidhur me këtë çështje, bëjmë me dije se skema e funksionimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore është plotësuar me miratimin më shumë se 90% të akteve nënligjore në zbatim të ligjit 111/2017.

Aktualisht, në fushën e ndihmës juridike kanë mbetur të pamiratuara vetëm 2 akte:

- Draft udhëzimi i përbashkët me DHASH, “Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore”;
- Draft udhëzimi i përbashkët me MFE-në, “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave dhe shpërblyerjes të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”.

Lidhur e këto 2 projektakte nënligjore, duke qenë se miratimi i tyre ka një karakter thelbësor për funksionimin “de facto” të ndihmës juridike dytësore, Ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë një sërë masash me qëllim përshpejtimin e procesit të finalizimit të tyre përmes zhvillimit të takimeve; komunikimit në mënyrë të vazhdueshme me përfaqësues të Dhash; analizimit të draft propozimeve të përcjella nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë dhe përcjelljes së një qëndrimi **duke marrë parasysh faktin se ndërmarrja e masave për reduktimin e tarifave ekzistuese është mëse e domosdoshme për mirëfunksionimin e sistemit të ndihmës juridike dytësore.**

Procedura e hartimit dhe miratimit të akteve është një procedurë e cila është duke u ndjekur nga ana e Ministrisë së Drejtësisë sipas përcaktimeve të ligjit 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

2.1 Hartimi i akteve të brendshme vetërregulluese të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

Që nga fillimi i ushtrimit të veprimtarisë së tyre, specialistët e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas janë angazhuar në hartimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas si dhe Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Qendrave të Ofrimit të Shërbimeve të Ndihmës Juridike Parësore.

Në mënyrë të përmbledhur, Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas përcakton rregulla lidhur me organizimin, funksionimin dhe administrimin e DNJF, duke u ndalur kryesisht në:

- a) Rregullimin e mënyrës së organizimit të DNJF, sipas strukturave;
- b) Përshkrimin e detyrave funksionale dhe kompetencave të nëpunësve dhe punonjësve administrativë sipas hierarkisë;
- c) Bashkërendimin e punës së strukturave të brendshme të Drejtorisë me institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike, si edhe publikun, medien dhe çdo subjekt tjetër të interesuar;
- d) Caktimin e rregullave të përgjithshme të etikës, mbarëvajtjes, disiplinës në marrëdhëniet e punës.

Kjo rregullore me memon datë 27.12.2019, i është përcjellë për miratim Ministrit të Drejtësisë dhe mbetemi në pritje të miratimit të këtij akti.

Për sa i përket *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Qendrave të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike Parësore* kjo rregullore në mënyrë të përmbledhur konsiston në:

- a) Përcaktimin e rregullave për organizimin e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore;
- b) Përshkrimin e detyrave funksionale për punonjësit e qendrave;
- c) Caktimin e kushteve, procedurave dhe afateve për dhënien e ndihmës juridike parësore;
- d) Caktimin e rregullave të përgjithshme të etikës, mbarëvajtjes dhe disiplinës në punë.

3. Ndhimja Juridike Parësore

Bazuar në nenin 13 të ligjit 111/2017, ndihma juridike parësore jepet nga:


- a) punonjësit me trajnim të posaçëm;*
- b) organizatat jofitimprurëse të autorizuara;*
- c) klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.*

Administrimi dhe promovimi i sistemit të ndihmës juridike parësore ka qenë një ndër prioritet kyç të DNJF. Përgjatë kësaj periudhe DNJF ka mbajtur një komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore si dhe me organizatat ndërkombëtare partnere si UNDP; OSFA apo EURALIUS me qëllim nxitjen e sistemit të ndihmës juridike parësore.

3.1 Hapja e qendrave të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore

Bazuar në kompetencën e caktuar në nenin 8, pika gj) DNJF administron, bazuar në urdhrin përkatës të Ministrit të Drejtësisë, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore.

Në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka vijuar me procedurat e hapjes së qendrave të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në qytete të cilat, bazuar në studimin konkret të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas por edhe në kuadër



të studimeve të përcjella nga Euralius, kanë më shumë nevoja për këtë natyrë shërbimi. Sikurse jeni në dijeni, aktualisht Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas administron 5 (pesë) qendra në bashkëpunim me SOROS dhe UNDP në qytetin e Tiranës; Elbasanit; Durrësit; Fierit dhe Lezhës (të pasqyruara në hartë)

- ***Për sa i përket qendrës së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Tiranë***

Duke qenë se kontrata e grantit nr. 8282, lidhur mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Fondacionit Shqipëria e Hapur për Shqipërinë “Soros” përfundoi duke përfunduar përfundimin e funksionimit të Klinikës Ligjore pranë Ministrisë së Drejtësisë si dhe duke qenë në kushtet kur Ministria e Drejtësisë, në kuadër të projektit: “Qendrat e Ndhmës Juridike parësore në Tiranë dhe Elbasan” ka nënshkruar një kontratë tjetër me Fondacionin Shqipëria e Hapur për Shqipërinë me qëllim ofrimin e shërbimeve ligjore nëpërmjet themelimit të dy qendrave të ndihmës juridike parësore në Tiranë dhe Elbasan, (kontrata e grantit nr. 8331) Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas propozoi pranë Ministrisë së Drejtësisë vijimin e procedurave për shfrytëzimin e ish klinikës ligjore pranë Ministrisë së Drejtësisë si Qendër e Ofrimit të Ndhmës Juridike Parësore në Tiranë me fondet e garantuara nga kontrata e grantit nr. 8331.

Ky propozim u miratua dhe aktualisht kjo qendër është nën administrimin e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas sipas përcaktimeve të ligjit 111/2017.

- ***Për sa i përket qendrave të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Durrës; Fier dhe Lezhë***

Qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Durrës; Fier dhe Lezhë janë hapur në muajin Mars 2020, nga Ministria e Drejtësisë me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe me fonde të Agjencisë Austriake për Zhvillim. Ky bashkëpunim do të vijojë më tej më hapjen e qendrave të tjera (ku për sa i përket qyteteve të planifikuara në të ardhmen e afërt është përfshirë qyteti i Beratit dhe i Pogradecit).

Në përputhje të planit për 6 mujorin e parë të vitit 2020, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka vijuar procedurat me qëllim hapjen brenda muajit Qershor 2020 të 3 (tre) qendrave të reja, duke e çuar numrin total të qendrave të administruara në 8 (tetë).

Për këtë arsye, me shkresën me nr. 583 prot., datë 28.01.2020, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas (përmes Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë) me lëndë: “*Kërkesë për bashkëpunim në kuadër të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti*” i është drejtuar kryetarëve të bashkisë Kukës; Gjirokastrë; Kavajë; Lushnjë; Berat; Pogradec; Sarandë; Vlorë; Tropojë; Tepelenë; Skrapar; Pukë dhe Përmet në kuadër të vendosjes në dispozicion të një mjedisi të përshtatshëm pranë këtyre bashkive.

Me qëllim përshpejtimin e procesit, korrespondenca shkresore është pasuar edhe me komunikime telefonike të vazhdueshme dhe deri më tani, bashkitë të cilat kanë shprehur gadishmërinë për vendosjen në dispozicion të ambienteve janë: Bashkia Gjirokastrë; Lushnjë; Berat; Pogradec; Tropojë dhe Skrapar.

Bazuar në studimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas evidentimin e qyteteve më shumë nevoja për përfitimin e shërbimit të ndihmës juridike falas si dhe koordiminim me UNDP , DNJF ka vlerësuar si 3 (tre) qytetet më të përshtatshme për hapjen e qendrave, qytetin e **Lushnjes; Gjirokastrës dhe Pogradecit.**

Për këtë arsye, kemi vijuar me komunikime me specifike me përfaqësuesit e Bashkive në qytetet respektive duke kërkuar vendosjen në dispozicion të të dhënave teknike për çdo ambient, të dhëna të parashtruara në katalogun e qendrave i cili i është përcjellë për vlerësim Ministrisë së Drejtësisë. Këto ambiente janë vlerësuar të përshtatshme nga ana e Ministrisë së Drejtësisë për të funksionuar si Qendra të Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas po vijon nga puna me procedurat e nevojshme për bërjen e tyre funksionale. Më konkretisht, bëjmë me dije si vijon:

Konkretisht katalogu i Qendrave të Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, konsiston në:

- ***Për qytetin e Lushnjes (qendër me buxhetin e shtetit)***

Është propozuar ambienti pranë Bashkisë Lushnje, ambient i cili pas verifikimeve në terren është vlerësuar i përshtatshëm. Ky ambient ndodhet 100 m larg godinës së Bashkisë me hyrje nga rruga kryesore, në katin e parë dhe lehtësisht e aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara. U konstatua e nevojshme kryerja e disa rikonstruksioneve mbi të cilat Bashkia Lushnje shprehu dakordësinë për realizimin e tyre Duke qenë se këto rikonstruksione janë kryer nga ana e Bashkisë, Ministria e Drejtësisë, do të vijojë me inagurimin e kësaj qendre duke qenë se është gati.

- ***Për qytetin e Gjirokastrës (në bashkëpunim me UNDP)***

Stafi teknik i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, verifikoi në terren ambientet e propozuara nga ana e Bashkisë Gjirokastrë. Një ndër problematikat e konstatuara ka të bëjë me aksesin e personave

me aftësi të kufizuar duke qenë se nevojitej ngjitja e një numëri të konsiderueshëm shkallësh prej guri dhe vendosja e një rampe ishte e pamundur.

Për këtë arsye, u propozua si një alternativë mjaft efiçente ambienti pranë zyrave të ADISA në Gjirokastrë. Këto ambiente ndodhen në një zonë mjaft të populluar dhe plotësojnë të gjitha kërkesat për sa i përket aksesit dhe privatësisë së qytetarëve përfitues. Zyra e vendosur në dispozicion pranë ADISA-s plotëson të gjitha kushtet e nevojshme të përshtatshmërisë për një Qendër Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.

Nga ana e përfaqësueve të UNDP na u përcoll planimetria lidhur me punimet e ambientit pranë zyrave të ADISA në Gjirokastrë. Nga DNJF u shqyrtua planimetria dhe u dakordësua për vijimin më tej, dakordësim i cili u shpreh edhe në rrugë zyrtare me anë të email, ku pas diskutimeve dhe me kabinetin e Ministrit u propozua si datë për inagurimin e qendrës data 15 Korrik 2020.

Për qytetin e Pogradecit (në bashkëpunim me UNDP)

Është propozuar ambienti pranë Bashkisë Pogradec, ambient i cili pas verifikimeve në terren u konsiderua i përshtatshëm. Duke qenë se nga ana e Ministrisë së Drejtësisë është vendosur për hapjen e kësaj qendre në bashkëpunim me UNDP, mbetemi në pritje të përfundimit të procedurave nga kjo e fundit.

3.2 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë me qëllim ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore

Bazuar në nenin 3 dhe 8 të ligjit 111/2017, "Klinikë ligjore" është njësi përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë, pas lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.

DNJF është duke bashkëpunuar me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore".

Aktualisht DNJF ka lidhur marrëveshje me 6 Institucione të Arsimit të Lartë dhe konkretisht:

1. Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës;
2. Kolegji Universitar "Wisdom";
3. Universiteti "Aleksandër Mojsiu" Durrës;
4. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë;
5. Universiteti European i Tiranës.
6. Kolegji Universitar "Bedër".

Këto institucione kanë vendosur në dispozicion zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuara. Klinikat, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit do të vijojnë me ofrimin shërbimit të ndihmës juridike parësore sipas standardeve të

përcaktuara në Urdhrin Nr. 531 Prot., datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të Shërbimeve të Ndhmës Juridike”.

Gjithashtu, DNJF është në komunikim me fondacionin SOROS me qëllim lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit të hapura nga ky fonadacion me qëllim rjetëzimin e këtyre klinikave në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në kuadër të promovimit të këtij sistemi ka planifikuar zhvillimin e një aktiviteti të përbashkët me Klinikat e Ligjit në kuadër të bashkëpunimit për ofrimin e ndihmës juridike parësore. Ky aktivitet është pezulluar për shkak të masave kufizuese të vendosura për shkak të gjendjes së pandemisë COVID-19. Mbetemi në pritje të zhvillimit të këtij aktiviteti në momentin e lehtësimit të masave të distancimit fizik në kuadër të pandemisë COVID-19.

3.3 Autorizimi i Organizatave Jofitimprurëse për dhënien e ndihmës juridike parësore

Referuar nenit 15 të ligjit 111/2017, Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Një ndër ofruesit e ndihmës juridike parësore janë organizatat jofitimprurëse të cilat do të autorizohen nga Ministria e Drejtësisë përmes një procedure të detajuar e cila është e parashikuar në dy akte nënligjore të dala në zbatim të ligjit 111/2017, dhe konkretisht:

- Vendimi nr. 55 datë 06.02.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”;
- Vendimi nr. 110, datë 06.03.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre. (mesatarisht procedura zgjat 45 ditë).

Referuar VKM nr. 55 datë 06.02.2019, institucioni përgjegjës për verifikimin e dokumentacionit dhe vlerësimin ose jo të përmbushjes së kriterëve ligjore nga ana e OJF-ve aplikuese është Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas e cila, relacionin vlerësues së bashku me propozimin përkatës ja përcjell Ministrisë të Drejtësisë në cilësinë e subjektit përgjegjës për dhënien e autorizimit. Autorizimi i dhënë nga Ministri i Drejtësisë është i vlefshëm për një periudhë **2 vjeçare** ku gjatë kësaj periudhe OJF-të e autorizuara përfitojnë financime nga buxheti i shtetit si dhe i nënshtrohen kontrollit dhe mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në kuadër të urdhrin të Ministrit të Drejtësisë mbi “Kriteret e vlerësimit, metodologjia dhe procedurat e mbikëqyrjes të ndihmes juridike”.

Në përputhje me parashikimet ligjore të përcaktuara në këtë VKM, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka vijuar me hapat që duhen ndërmarrë me qëllim përfundimin e procedurës së autorizimit të OJF-ve, që ofrojnë ndihmë juridike parësore, konkretisht:

Me shkresën nr. 65 Prot., datë 12.02.2020, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe ka kërkuar publikimin e njoftimit për hapjen e procedurave të aplikimit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti.

- *Në datën 26.02.2020*, është realizuar njoftimi për hapjen e procedurave të aplikimit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti, është publikuar në faqen zyrtare të MD dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare në QBZ.
- *Hapja e procedurave të aplikimit është njoftuar dhe në rrugë elektronike.* Të gjitha OJF-të, sipas një liste që disponon DNJF, janë kontaktuar përmes njoftimit me email në të cilin u është vendosur në dispozicion linku i MD-së dhe linku i publikimit në QBZ, në mënyrë që OJF-të të njihën me afatet që janë përcaktuar, dokumentacionin e kërkuar dhe procedurat e dorëzimit. *(emaillet janë dërguar në datat 27 dhe 28 shkurt 2020 – rreth 100 organizatave).*
- Me shkresën nr. 65/1 Prot., datë 24.03.2020, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe ka kërkuar publikimin e shtyrjes së afatit të aplikimeve nga OJF-të, si pasojë e situatës së krijuar nga Covid-19.
- *Në datën 24.02.2020*, njoftimi për shtyrjen e afatit të aplikimeve nga OJF-të, është publikuar në faqen zyrtare të MD dhe *në datën 30/03.2020*, është publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare në QBZ.
- *Shtyrja e afatit të aplikimit nga OJF-të, që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore është njoftuar dhe në rrugë elektronike.* Të gjitha OJF-të, sipas një liste që disponon DNJF, janë kontaktuar përmes njoftimit me email në të cilin u është shpjeguar shtyrja e afatit si pasojë e situatës së krijuar. Organizatave u është bërë me dije, se ato të cilat kanë dokumentacionin tashmë të përgatitur mund të vijnë me dorëzimin e dosjes së aplikimit dorazi ose përmes shërbimit postar pranë DNJF, në Ministrinë e Drejtësisë. Gjithashtu, OJF-të janë sugjeruar të vijnë me përgatitjen e dokumentacionit që nuk merret nga gjykatat në mënyrë që të fitojnë kohë me përgatitjet e dosjeve. *(emaillet janë dërguar në datat 18.03.2020 dhe 07.04.2020 - rreth 100 organizatave).*

Pranë DNJF janë dorëzuar disa dosje aplikimesh, referuar dhe njoftimeve nga ana e drejtorisë së është shtyrë afati i aplikimeve gjë që nuk passjell ndërprerje të tyre dhe procedura e dorëzimit të dokumentacionit ka vijuar. Aktualisht, **kanë dorëzuar dokumentacionin 15 organizata jofitimprurëse.**

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, duke marrë në konsideratë rifillimin e veprimtarisë gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë, bazuar në Vendimin Nr. 143, datë 22.04.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore”, si dhe duke patur parasysh që referuar Vendimit nr. 55 datë 06.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”, një pjesë e dokumentacionit të kërkuar duhet të sigurohet nga OJF-të nëpërmjet gjykatës, ka proceduar me njoftimin e afatit përfundimtar

për pranimin e aplikimeve për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore deri më datë **20.06.2020**.

Me përfundimin e këtij afati, Komisioni i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas ngritur me urdhër nr. 199, datë 18.06.2020, ka vijuar me shqyrtimin e detajuar të dosjeve të përcjella duke hartuar për secilin aplikim një relacion përmbledhës shoqëruar edhe me propozimin për miratimin ose jo të autorizimit nga Ministri i Drejtësisë.

Aktualisht, kanë dorëzuar dokumentacionin 15 organizata jofitimprurëse. Pas shqyrtimit të aplikimeve është proceduar me shkresa për plotësim dokumentacioni për të gjitha OJF-të aplikuese (*shkresë e dërguar më datë 2.07.2020*). Me përfundimin e afatit 10 ditor (10 ditë pune), më datë **16.7.2020**, do të vijohet me plotësimin e relacioneve dhe dërgimin e propozimeve për vlerësim.

4. Ndhma Juridike dytësore

Ndhma juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12. Ligjit nr.111/2017

Në zbatim të kompetencave të përcaktuara në nenin 8 të ligjit Nr. 111/2017, gërma k) DNJF lidh, deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore. DNJF ka vijuar me lidhjen e kontratave me avokatët e miratuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë për vitin 2020. Lista e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike falas është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe aktualisht, për vitin 2020 kanë lidhur kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore **65 avokatë**

Gjithashtu, DNJF në përmbushje të detyrave të saj funksionale të parashikuara në nenin 22 të ligjit 111/2017, po vijon me ndjekjen e seancave gjyqësore me objekt dhënien e ndihmës juridike dytësore me qëllim procedimin me ankimin e tyre nëse kërkesat me objekt dhënien e ndihmës juridike dytësore janë dukshëm abuzive ose haptazi të pabazuara.

DNJF ka proceduar me kërkesa për ndreqje gabimesh të vendimeve gjyqësore për dhënie ndihme juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga pagimi i tarifave apo shpenzimeve gjyqësore , të cilat kanë rezultuar si më poshtë:

- *Caktim nga ana e gjykatës të avokatit që do të përfaqësojë kërkuenin në procesin gjyqësor përkatës në dispozitiv vendimi, duke përvetësuar kompetencat që ligji Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" ia atribuon Dhomave Vendore të Avokatisë,*
- *Moszbatim parashikimesh të nenit 23 të ligjit Nr.111/2017, duke mos ia komunikuar vendimin përkatës subjekteve të përcaktuara në dispozitiv;*
- *Mosparashikim i të drejtës së ankimit ndaj vendimit gjyqësor dhe afatin për paraqitjen e tij, në kundërshtim me parashikimet ligjore të nenit 22 pika 9 të ligjit Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti";*

- Disponim mbi kërkesë për përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, kërkesë kjo e cila nuk është bërë nga ana e kërkuarit dhe as identifikuar në objektin e kërimit.
- Aktualisht janë kryer 6 kërkesa për ndreqje gabimesh ndaj vendimeve gjyqësore, kërkesa të cilat janë pranuar nga ana e gjykatave.

Janë ekzekutuar detyrime kontraktuale të strukturës së mëparshme KSHNJ me avokatët si ofrues të ndihmës juridike, konkretisht 24 dosje të përfunduara.

Gjithashtu janë kryer 3 pagesa të detyrimeve kontraktuale me avokatët që kanë ofruar ndihmë juridike dytësore për dy dosje të përfunduara nga ana e tyre.

Për sa i përket detyrimeve të përcaktuara në nenin 31 të ligjit: *Rastet e kthimit të përfitimeve në rast se një person, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimin nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, i kanë ndryshuar rrethanat në një mënyrë të tillë që nuk plotëson kriteret ligjore për të qenë subjekt përfitues i ndihmës juridike dytësore, apo detyrimit të përcaktuar në nenin 32 të ligjit, Rimbursimi në rastin e dhënies së informacioneve të rreme ose të pavërteta*, DNJF për periudhën Janar-Qershor 2020, pas verifikimit të vazhdueshëm të çështjeve gjyqësore, nuk ka konstatuar asnjë rrethanë apo indicie që mund të përfshijë rastet e përcaktuara në nenin 31 dhe 32 të ligjit.

5. Mbjajtja, mbledhja, plotësimi dhe administrimi i të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve

Bazuar në nenin 8 të ligjit të sipërcituar, DNJF:

- administrojnë bazuar në urdhrin përkatës të Ministrit të Drejtësisë, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore.*
- mbledh dhe analizojnë informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizojnë fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitimin e saj.*

Bazuar në këtë dispozitë, me udhëzimin nr.1, datë 08.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave” janë përcaktuar në mënyrë të detajuar të dhënat që çdo qendër e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore duhet të raportojë.

Konkretisht, në pikën 3 të këtij udhëzimi përcaktohet shprehimisht se: “Çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti i dërgon periodikisht çdo muaj Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, të dhënat e kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve kërkuuese të paraqitura për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti. Të dhënat dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues”

Plotësimi dhe përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti kryhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga momenti i depozitimit të informacionit pranë DNJF, sipas pikes 3 të këtij udhezimi Referuar udhëzimit të sipërcituar, DNJF ka hartuar një format raportimi tip i cili përcillet nga të gjithë ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore.

Bazuar nga të dhënat e administruara, personat e autorizuar pranë DNJF po vijnë me administrimin në mënyrë të detajuar të të gjitha të dhënave të çështjeve me objekt dhënien e ndihmës juridike parësore apo dytësore duke i administruar ato në një database të dedikuar.

6. Dhënia e ndihmës juridike ONLINE

6.1 Funksionimi i platformës juristionline.al me qëllim dhënien e ndihmës juridike parësore online për të gjithë qytetarët

Në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e pandemisë (Covid-19), u mbyllën qendrat e ndihmës parësore, dhe një pjesë e procesve të punës u pezulluan, duke qënë një shërbim ngushtësisht i lidhur me qytetarin, kurrësesi ndihma juridike nuk mund të mos ofrohej dhe në këto kushte kufizimi.

Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka vijuar me ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes **platformës juristionline.al**.

Përmes kësaj platforme çdo qytetar ka mundësi të këshillohet dhe informohet lidhur me gjithë legjislacionin e miratuar në kuadër të parandalimit të përhapjes së virusit Covid-19, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.

Pyetjet e dërguara në këtë platformë, që nga fillimi i funksionimit të saj, kanë qënë të shumëllojshme duke theksuar edhe njëherë nevojën që kanë patur qytetarët për një sistem të tillë i cili deri më tani figuron të jetë mjaft rezultativ.

Kjo platformë ka rezultuar mjaft e sukseshme pasi vihet re një numër i konsiderueshëm qytetarësh të cilët i janë drejtuar me qëllim marrjen e një orientimi ligjor mbi problematikat e tyre.

Një komponent shumë i rëndësishëm i ofrimit të ndihmës juridike falas është cilësia e këtij shërbimi. Shërbimi i ndihmës juridike falas quhet së është garantuar në mënyrë të plotë, me efikasitet dhe efektivitet vetëm atëherë kur është ofruar me cilësinë e duhur. Në këtë kuadër, është shumë e rëndësishme që t'i kushtohet vëmendja e duhur kombinimit të shifrave sasiore me të dhënat e cilësisë së shërbimit. Kombinimi i të dhënave statistikore me cilësinë që ka prodhuar këto të dhëna janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën, si pjesë e një pakete unike shërbimi dedikuar qytetarit DNJF si institucioni kompetent në kuadër të vlerësimit të cilësisë të këtij shërbimi është duke vijuar të analizojë me kujdes përgjigjet e avokatëve/juristëve të angazhuar në platformë si dhe kohën e kthimit

të tyre me qëllim përcjelljen e sugjerimeve në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimit, gjë për të cilën do të shprehemi në seksionin e monitorimit të ofrimit të cilësisë së shërbimit.

6.2 Vendosja në dispozicion e numrit të gjelbër (falas) 08001010

Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarrë për qytetarët që kanë nevojë për shërbime të ndihmës juridike, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin SOROS kanë vendosur në dispozicion një linjë të gjelbër në të cilën do të kenë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike. Vendosja e një numri falas sidomos gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore si rrjedhojë e pandemisë Covid-19, është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. Si platforma juristionline ashtu edhe linja e gjelbër janë masa të shtuara duke garantuar shërbime sa më pranë qytetarit.

Në këtë kuadër, DNJF është angazhuar plotësisht duke ndërmarrë hapa të njëpasnjëshëm për të bërë funksional linjën e gjelbër nga të gjithë kompanitë telefonike në vend, konkretisht si vijon:

- Komunikime të vazhdueshme me kompanitë telefonike të: Telecom; Vodafone dhe Albtelecom;
- Lidhjen e kontrateve me kompanitë për ofrimin e shërbimit duke mundësuar kështu aksesin e numrave nga të gjitha kompanitë telefonike drejt linjës së gjelbër;
- Janë marrë në dorëzim telefonat e vendosur në dispozicion nga kompania Telecom dhe aktualisht janë pranë Qendrës së Ndihmës Parësore Tiranë, në ambjentet e MD.
- Juristët e qendrës janë duke trajtuar me kujdes çdo telefonatë të ardhur nga qytetarët;
- Stafit i DNJF është në komunikim të vazhdueshëm me qendrën e Tiranës për të administruar të dhëna të gjeneruara nga telefonatat e qytetarëve për të patur jo vetëm një statistikë të këtyre rasteve por edhe një pasqyrë të llojit të pyetjeve të qytetarëve, nevojave të tyre dhe përgjigjet e dhëna nga juristët, adresimi i rasteve sipas çdo specifike. *(jemi në pritje të përcjelljes prej tyre të një materiali përmbledhës mbi telefonatat e kryera për të përgatitur në vijim raport mbi baza mujore edhe për telefonatat e kryera).*

7. Vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes

Bazuar në nenin 8 të ligjit 111/2017, DNJF zbaton sistemin e vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike duke mbikëqyrur standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët

Një komponent shumë i rëndësishëm i ofrimit të ndihmës juridike falas është cilësia e këtij shërbimi. Shërbimi i ndihmës juridike falas quhet së është garantuar në mënyrë të plotë, me eficiencë dhe efektivitet vetëm atëherë kur është ofruar me cilësinë e duhur. Në këtë kuadër, është shumë e rëndësishme që t'i kushtohet vëmendja e duhur kombinimit të shifrave sasiore me të dhënat e cilësisë së shërbimit. Kombinimi i të dhënave statistikore me cilësinë që ka prodhuar këto të dhëna janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën, si pjesë e një pakete unike shërbimi dedikuar qytetarit.

Referuar Ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në nenin 8 të tij , përcaktohet si një ndër detyrat e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas: Zbatimi i sistemit të vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike dhe mbikëqyrja çdo vit e standardeve të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët.

Situata e krijuar si rrjedhojë e pandemisë Covid- 19 ka vështirësuar procesin e mbikëqyrjes, monitorimet pranë zyrave të ofruesve të ndihmës juridike nën kushtet e masave kufizuese, por sapo janë lehtësuar masat dhe nën zbatimin e rregullave mbrojtëse stafi ka vijuar dhe aktualisht do të vijojë me monitorimet e parashikuara.

- ***Për procesin e mbikëqyrjes sipas përcaktimeve të metodologjisë***

Procesi i mbikëqyrjes ka vijuar në përputhje dhe në konsultim të vazhdueshëm me metodologjinë e miratuar² për këtë qëllim duke ndjekur formatet e dakorduara në këtë akt, sipas anekseve bashkëlidhur urdhrat të metodologjisë.

Sipas metodologjisë, hapat që ndiqen për monitorimin e ndihmës juridike parësore janë: *monitorimi fillestar* (ambjentet, përshtatshmëria e zyrave etj), *monitorime tre-mujore* (inspektim një ditë pranë qendrave), dhe *monitorim i vazhdueshëm* (raporte mujore të tyre dhe komunikim i vazhdueshëm), duke ndjekur indikatorët e vlerësimit të përcaktuar në metodologji. Në fund të çdo viti pune do të hartohet një raport përfundimtar performance për juristët/avokatët që ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike pranë qendrave.

E njëjta procedurë vijon dhe me mbikëqyrjen e avokatëve të ndihmës juridike ku sipas metodologjisë do të kryhen monitorime fillestare dhe monitorim i vazhdueshëm për çdo avokat që ofron ndihmë juridike. Stafi i mbikëqyrjes ka akese në dokumentat elektronikë të tyre dhe më dosjet për çdo çështje. Raportet përfundimtare të performancës së avokatëve do të hartohen në përfundim të çështjeve gjyqësore të ngarkuara.

Raportet përfundimtare të performancës për ndihmën parësore dhe dytësore përmbajnë një vlerësim narrativ sipas indikatorëve të përcaktuar të vlerësimit, totalin e pikëve të marra sipas sistemit të pikëzimit, komente dhe rekomandime nga struktura e mbikëqyrjes DNJF dhe komente e rekomandime nga juristi/avokati i qendrës apo avokati i ndihmës juridike dytësore sipas llojit të ndihmës juridike të ofruar.

Sipas këtyre hapave DNJF ka vijuar me ngritjen e grupeve të punës për vijimin procesit të mbikëqyrjes (stafi i Drejtorisë së Mbikëqyrjes, ngarkuar me përgjegjësinë e kontrollit të cilësisë dhe mbikëqyrjen e shërbimit të ndihmës juridike), duke e ndarë si vijon:

7.1 Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore

Ofruesit e ndihmës juridike parësore, sikurse janë përmendur gjatë këtij raporti janë:

² Urdhër Nr 531 Prot , datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të Shërbimeve të Ndhmës Juridike”.

- Qendrat e Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore
- Organizatat jofitimprurëse të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti dhe
- Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve (me të cilat DNJF ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për këtë qëllim).

Duke qënë se procedurat për autorizimin e OJF-ve për ofrimin e ndihmës juridike parësore nuk kanë përfunduar ende dhe procesi i lidhjes së kontratave me Klinikat e Ligjit është duke vijuar (*do të pasohet me vijimin e një aktiviteti me të gjitha klinikat për të folur në terma konkretë për ndihmën juridike që do të ofrohet prej tyre dhe bashkëpunimin me DNJF*), procedurat e mbikëqyrjes kanë vijuar duke u ndalur si fillim tek qendrat e ndihmës parësore, konkretisht:

- Qendra e Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore ne qytetin e Elbasanit

Kjo qendër është hapur nga Ministria e Drejtësisë në datën 16 tetor 2019 dhe përgjatë gjithë kësaj periudhe të funksionimit të saj DNJF ka qënë në kontakt të vazhdueshëm me juristët e qendrës për dërgim të dhënash, rastet e trajtuara prej tyre, problematika dhe të tjera mbi ecurinë e punës. Në datën 15 maj 2020, sipas urdhrin të hartuar nga DNJF për ngritjen e grupit të punës ka kryer monitorimin pranë ambjenteve të qendrës duke ndjekur nga afër procesin e punës, respektimin e kodit të etikës, rastet e trajtuara sipas database-eve të mbajtur nga juristët për të cilat janë mbajtur procesverbale nga stafi. Grupi i mbikëqyrjes ka përgatitur një raport mbi kryerjen e këtij monitorimi është përcjellë në MD për dijeni, vlerësim e komente.

- Qendra e Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore ne qytetin e Durrësit Fierit dhe Lezhës

Për qendrat e Durrësit, Fierit dhe Lezhës stafi i mbikëqyrjes në DNJF ka vijuar me komunikimin sa i përket dërgimit të raporteve mujore prej tyre. Sipas kohës sa hapjes së secilës qendër nga MD, jemi duke vijuar me ngritjen e grupeve të punës për monitorimet tre mujore sapo të plotësohet periudha e duhur për të treja qendrat (*qendra e Fierit është hapur në 27 shkurt 2020 dhe qendra e Durrësit në 6 mars 2020*). Qendrat kanë dërguar raportet mujore deri në muajin maj dhe jemi në pritje për raportet e muajit qershor. Gjithashtu, është hartuar kalendari i mbikëqyrjes për monitorimin e qendrave dhe gjatë periudhës 2 javore të muajit korrik do të realizohet monitorimi 3 mujor i qendrave në Fier, Durrës dhe Lezhë.

- Qendra e Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore ne qytetin e Tiranës

Për qendrën e Tiranës, duke qënë se është marrë në administrim nga MD në fund të muajit prill, jemi në komunikim për raportin mujor të muajit Qershor prej tyre.

Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike dytësore

Mbikëqyrja ka vijuar dhe për shërbimin e ndihmës juridike dytësore të ofruar nga avokatët e ndihmës juridike. Për avokatët të cilët kanë përfunduar çështjet e ndihmës juridike (tre prej të cilëve janë paguar nga DNJF), ka filluar procesi i mbikëqyrjes dhe kontrollit. Është ngritur grupi i punës dhe janë hartuar

raportet e performancës për secilin avokat në të cilat janë paraqitur rekomandime dhe vlerësimi sipas sistemit të pikëzimit.

Informacion mbi monitorimin e ofruesve të ndihmës juridike dytësore:

- Është realizuar monitorimi i Qendrës së Elbasanit më datë 15.04.2020, në zbatim të Urdhrit nr. 158, datë 13/05/2020.
- Është realizuar monitorimi për Av. Rajmonda Gjoni më datë 18.06.2020, në zbatim të Urdhrit nr. 194, datë 16.06.2020.
- Është realizuar monitorimi për Av. Stefan Topalli më datë 19.06.2020, në zbatim të Urdhrit nr. 195, datë 16.06.2020.
- Është realizuar monitorimi për Av. Suela Sulkja më datë 23.06.2020, në zbatim të urdhrit nr. 208, datë 19.06.2020.
- Është planifikuar sipas kalendarit të monitorimit realizimi i mbikëqyrjes për Av. Erisilda Shpata (Durrës); Qendrën e Durrësit, Qendrën e Fierit dhe Qendrën e Lezhës.

7.2 Mbikëqyrja e shërbimit të ndihmës juridike online

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në kuadër të vlerësimit të cilësisë të këtij shërbimi ka analizuar me kujdes përgjigjet e avokatëve/juristëve të angazhuar në platformë me qëllim përcjelljen e disa sugjerimeve të parashtruara në vijim. Është përfunduar tashmë raporti për periudhën maj-qershor 2020 në të cilin janë parashtruar problematikat e qytetarëve, zgjidhjet/përgjigjet e ofruara, përfundime e gjetje të stafit të ngarkuar me mbikëqyrjen (dy specialistë të ngarkuar nga secila drejtori), si dhe me disa rekomandime të vlefshme për ofruesit e ndihmës juridike online.

Konkretisht, disa nga rekomandimet konsistojnë në:

- *Orientimi ligjor lidhur me përfitimin e ndihmës juridike dytësore.*

Sugjerojmë që gjatë dhënies së përgjigjeve për rastet e trajtuara, të mbahet në konsideratë orientimi më i detajuar sa i përket përfitimit të ndihmës juridike dytësore

- *Promovimi i sistemit të ndihmës juridike falas.*

Pasi ofrohet përgjigja lidhur me problematikën konkrete të qytetarit, sugjerojmë të mbahet në konsideratë, aty ku është e përshtatshme, që të jepet një informacion i shkurtër mbi sistemin e ndihmës juridike, ofruesit e këtij shërbimi, kontakte etj.

- *Disa përgjigje për të njëjtën problematikë.*

Në disa prej rasteve, vihet re një paqartësi sa i përket përgjigjeve të dhëna dhe krijohet përshtypja sikur ka më shumë se një zgjidhje/përgjigje për të njëjtën gjë. Sugjerojmë të mbahet në konsideratë dhe të ketë një koordinim ndërmjet juristëve që e ofrojnë shërbimin në mënyrë që përgjigjet të jenë plotësuese të njëra – tjetra (të shtohet informacion që nuk është dhënë në përgjigjen e parë), jo të jenë e njëjta përgjigje por me argumentim ndryshe.

- *Rastet kur qytetari ka nevojë për orientim se ku të drejtohen për të zgjidhur problemin e tyre.*

Në veçanti kur rastet janë sensitive, probleme shëndetësore, raste dhune etj.. sugjerohet që përgjigja e dhënë të mos përqëndrohet vetëm tek organi ku duhet të drejtohen por dhe duke i lehtësuar në aspektin e hapave, procedurës që duhet të ndjekin (për aq sa mund të jepet si informacion). Përgjigja të mos fokusohet vetëm tek organi përgjegjës por t'i behet e ditur qytetarit dhe një informacion lidhur me hapat e parë që duhet të ndjekë / si mund t'i drejtohet atij institucioni. Sepse duke e shprehur vetëm institucionin ku duhet të drejtohen, duket sikur nuk i jepet një rrugë drejt zgjidhjes por një tjetër hallkë për të kapërcyer.

8. Zhvillimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike, kushtet për përfitimin e saj dhe edukimin ligjor të publikut

Duke qenë tërësisht të vetëdijshëm se rritja e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitimin e saj përveçse një detyrimi ligjor (neni 8 i ligjit 111/2017), është një nga komponentët me thelbësorë të funksionimit të sistemit të ndihmës juridike dhe forcimit të aksesit të qytetarëve në drejtësi, DNJF është duke i kushtuar një vëmendje të shtuar zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe edukimit ligjor të publikut duke hartuar kalendarin e aktiviteteve si dhe një plan konkret pune. Përgjatë funksionimit të saj, DNJF i ka zhvilluar në këtë kuadër disa aktivitete që kanë në fokus ndërgjegjësimin dhe edukimin ligjor të publikut jo vetëm duke u përqëndruar tek sistemi i ndihmës juridike falas por duke u ndalur edhe në informimin ligjor të publikut përmes faqes zyrtare të dedikuar të drejtorisë, rrjeteve sociale dhe videove informuese.

8.1 Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere

Me qëllim përmbushjen e këtij objekti, Drejtoria e Ndihmës të detajuar masash, dedikuar posaçërisht aktiviteteve dhe seminareve ndërgjegjësuere/ Juridike Falas ka hartuar një plan informuese (bashkëlidhur këtij raportimi)

Për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të COVID-19, shumica e aktiviteteve të planifikuara nuk arritën të realizohen. Konkretisht, përgjatë periudhës Janar-Mars 2020, DNJF ka zhvilluar 2 aktivitete:

- *Aktivitet Ndërgjegjësues "Aksesi në drejtësi për të miturit në konflikt me ligjin", Kavajë, 09 mars 2020*

Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve është një nga parimet më thelemore të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Formë e mbrojtjes së këtij interesi është edhe aksesi në drejtësi për të gjithë fëmijët në konflikt me ligjin duke garantuar një shërbim ligjor falas dhe cilësor. Nga ky këndvështrim, ishte e nevojshme të bëheshin ndryshime ligjore në legjislacionin e procedurës penale dhe gjithashtu në ligjin "Për ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti".

Ligji 111/2017, "Për Ndihmën Juridike të garantuar nga Shteti", në referim të nenit 11 të tij, tashmë i ka cilësuar të miturit si subjekte të posaçëm të cilët, pavarësisht nga të ardhurat e tyre janë përfitues të drejtëpërdrejtë të ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Konkretisht, fëmijët që jetojnë në institucione të kujdesit shoqëror; fëmijët në kujdestari, të cilët kërkojnë të fillojnë një proces pa pëlqimin e përfaqësuesit të tyre ligjor ose kundër përfaqësuesit të tyre ligjor; viktimat e mitur dhe të

miturit në kundërshtim me ligjin, në çdo fazë të procedurës penale (për të cilën nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme), mund të përfitojnë që nga këshillimi ligjor (ndihma juridike parësore) deri në përfaqësimin e çështjeve në gjykatë (ndihmë juridike sekondare).

Gjithashtu, duke ritheksuar edhe njëherë mbrojtjen e interesave më të lartë të fëmijëve, është detyrim ligjor që juristët/avokatët që ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike falas, të jenë të specializuar në sistemin e Drejtësisë për të mitur përmes ndjekjes së trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme të organizuara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas/Departamenti i Administratës Publike/ Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Pavarësisht lehtësirave që ka sjellë ky ligj në kuadër të përfitimit të shërbimit ligjor falas, vihet re se nga të miturit apo familjarët e tyre, nuk ka kërkesa për përfitim të ndihmës ligjore falas. Kjo mund të jetë si shkak i mungesës së informacionit mbi këtë shërbim . Në këto kushte, nga ana e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është planifikuar zhvillimi i një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuese duke u ndalur veçanërisht tek kategoritë e veçanta të ligjit.

Pjesë e këtyre aktiviteteve ishte dhe Aktiviteti “Aksesi në drejtësi për të miturit në konflikt me ligjin” i cili u zhvillua me qëllim ndërgjegjësimin e të miturve pranë Qendrës së Re-Integrimit të të Miturve Kavajë.

Ky aktivitet u zhvillua në 3 seksione ku përfaqësuesit e ndihmës juridike falas patën mundësinë të bashkëbisedonin me të miturit e kësaj qendre duke i shpjeguar në mënyrë të thjeshtëzuar se si ata apo prindërit e tyre mund të përfitonin nga shërbimet ligjore falas.

Të miturve ju vendos në dispozicion një manual i thjeshtëzuar me 7 pyetje për përfitimin e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe konkretisht:

- ✓ Çfarë është Ndhma Ligjore Falas?
- ✓ Kush përfiton nga ky shërbim?
- ✓ Çelloj mbrojtjeje mund të gjej?
- ✓ Kujt mund t’i drejtohem për të përfituar nga ky shërbim?
- ✓ Cila është procedura që duhet të ndjek?
- ✓ Si mund të na kontaktoni?

Të miturit gjatë takimit informues u shfaqën mjaft të interesuar për t’u informuar mbi mënyrën e përfitimit të këtij shërbimi. Shumica prej tyre i shprehën problematikat ligjore më të cilat përballen familjarët e tyre të cilat lidheshin më së tepërmi me “detyrimin për ushqim” si dhe me kërkesat për “revokimin e avokatëve të caktuar kryesisht”.

Me qëllim zgjidhjen e këtyre problematikave dhe përfitimin e shërbimit nga këta të mitur, përfaqësuesit e DNJF shkëmbyen kontaktet me Punonjësit Socialë të Qendrës së Re-Integrimit të të Miturve Kavajë të cilët ishin mëse të gatshëm për bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas në trajtimin e këtyre rasteve.

- *Tryezë e Përbashkët në kuadër të promovimit dhe nxitjes së sistemit të ndihmës juridike falas, Elbasan 05 Mars 2020*

Më datë 5 Mars DNJF me zhvilloi një tryezë të përbashkët me përfaqësues nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Bashkia Elbasan, Drejtoria e Policisë Vendore dhe përfaqësues të Organizatave Jofitimprurëse. Qëllimi i kesaj tryeze konsistonte në rendesine dhe efikasitetin që duhet te ketë Sistemi i Ndhmës Juridike Paresore dhe fokusin për te rritur urat e bashkëpunimit nderinstitucional në mënyrë të tillë që çdo qytetari t'i garantohet akses në Drejteësi. Tryeza rezultoi mjaft frytdhënëse në kuadër të lidhjes së urave të bashkëpunimit me aktorët ndër institucionalë.

- *Intervistave televizive me qëllim përcjelljen e njohurive mbi sistemin e ndihmës juridike falas tek qytetarët*

Më datë 17 qershor 2020, 2 specialistë të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas janë ftuar në emisionin "Mirmëngjes Shqipëri" në Radio Televizionin Shqiptar gjatë të cilit është diskutuar mbi ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas gjatë periudhës së pandemisë, sistemin e ndihmës juridike falas, ofruesit e këtij shërbimi dhe kategoritë përfituese.

Linku i intervistës: <https://youtu.be/tv-4wtNcODg>

8.2 Hapja e faqes zyrtare Web të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

Për sa i përket hapjes së faqes zyrtare web të DNJF, në kushtet kur institucioni ynë nuk ka në organikën e tij një specialist përgjegjës për çështjet e teknologjisë së informacionit, ka kërkuar mbështetjen e EURALIUS (bazuar në aktivitetin 1.4.1 "Support of the Ministry of Justice and other institutions in the administration and provision of free legal aid service").

DNJF ka patur një komunikim të vazhdueshëm me përfaqësuesen e EURALIUS me qëllim krijimin e faqes. Aktualisht faqja është finalizuar dhe është vendosur në dispozicion të publikut.

8.3 Promovimi i sistemit të shërbimit të ndihmës juridike falas përmes rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram

Duke qenë se sistemi i ndihmës juridike falas është një sistem i lidhur ngushtësisht me qytetarët dhe duke marrë parasysh faktin se ky shërbim është relativisht i ri dhe i panjohur për të shumtën e qytetarëve, DNJF është duke punuar në mënyrë të vazhdueshme për promovimin e këtij sistemi përmes rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram të cilat janë mjaft të përdorshme nga qytetarët. Kemi vijuar me postime të vazhdueshme informative mbi procedurat që duhen ndjekur për përfitimin e këtij shërbimi si dhe është publikuar nga ana e DNJF *një manual i thjshtëzuar i shërbimeve të ofruara përmes ligjit 111/2017.*

8.4 Promovimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore/dytësore përmes vendosjes së posterave pranë institucioneve kryesore në vend.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, më datë 14 Maj 2020, organizoi një takim me z. Kestutis Vaskevicius (International Long Term Expert Head of Administration EURALIUS Vnë kuadër të

kërkesës për asistencë në promovimin e sistemit të ndihmës juridike falas (bazuar në aktivitetin 1.4.1 të Euralius). Gjatë këtij takimi u arrit dakordësia për mundësimin e dizajnit dhe printimit të mbi 500 posterave adezivë promovues të sistemit të ndihmës juridike falas me qëllim afishimin e tyre pranë institucioneve shtetërore në gjithë Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, në kuadër të promovimit kemi vijuar me dërgimin e shkresës me nr. 148 prot., datë 08.05.2020, drejtuar Gjykatave si dhe me shkresën me nr. 163 prot., datë 18.05.2020, drejtuar Prokurorive të Republikës së Shqipërisë lidhur me bashkëpunimin në kuadër të publikimit të listës së avokatëve të ndihmës juridike dytësore, shumica e të cilave e kanë bërë të mundur këtë kërkesë.

9. Kontribute të DNJF në kuadër të raportimeve për Bashkimin Evropian

DNJF si një institucion i dedikuar sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, është angazhuar që prej fillimit të funksionimit në hartimin e kontributeve të vazhdueshme në kuadër të proceseve që ndiqen me Bashkimin Evropian. Një komponent shumë i rëndësishëm kur flitet për reformën në drejtësi dhe hapat e ndjekura nga Shqipëria në kuadër të procesit të integritetit evropian është aksesimi në drejtësi, garantimi i qasjes së barabartë për të gjithë shtetasit. Në këtë kuadër, dhe duke patur në vëmendje të veçantë rëndësinë që çdo kontribut i ofruar në këtë drejtim, nga çdo institucion publik është shumë i rëndësishëm që për Shqipërinë, më në fund të celen negociatat me BE, drejtorja është angazhuar maksimalisht në përcjellje të çdo kontributi, përditësimi mbi zhvillimet më të fundit dhe të çdo të dhëne statistikore të kërkuar. Gjatë vitit 2020, disa nga kontributet e dhëna lidhen me:

- Hartimin e kontributit të dytë të Qeverisë shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020_DNJF, (komponenti i ndihmës juridike);
- Hartimin e kontributit të tretë të Qeverisë shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020_DNJF, (komponenti i ndihmës juridike);
- Takimi i Nën – Komitetit, 30 Qershor 2020, “Drejtësi, Liri dhe Siguri”.

10. Angazhim i DNJF në kuadër të dokumentave strategjike (*Strategji, plane veprimi, raporte monitorimi*)

10.1 Angazhim i DNJF në kuadër të hartimit të një strategjie dhe plani veprimi për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas

Në fillim të muajit qershor 2020, ka nisur procesi i diskutimeve mbi hartimin e një dokumenti strategjik për Drejtorinë. Në këtë proces Drejtorja është mbështetur nga ekspertë të Euralius V të cilët asistohen nga një grup përfaqësues i stafit teknik të DNJF. Gjatë këtij muaji janë zhvilluar 4 takime teknike pune online në të cilat kanë marrë pjesë të anëtarët e grupit të punës. Gjatë këtyre takimeve është diskutuar mbi objektivat dhe prioritetet e Drejtorisë të cilat përkthyer në hartimin e një analize të strukturuar (SWOT). Në mënyrë të vazhdueshme stafi i DNJF ka dhënë kontribut me komente në funksion të këtij dokumenti i cili është planifikuar të përfundohet në fund të muajit korrik 2020. Puna

bazë për hartimin e strategjisë është kryer (*përmendim këtu analizën SWOT; Problem Tree; Solution Tree si dhe Log Frame*), mbetet vetëm dhënia e komenteve përfundimtare dhe miratimi nga ana e Drejtorisë dhe Ministrisë.

10.2 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP)

Gjatë këtyre muajve është vijuar me procesin e hartimit të Planit të Veprimit në zbatim të SELP (i cili pritet të miratohet shumë shpejt).

Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, është një instrument i rëndësishëm me fokus parashikimin e masave konkrete mbi informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve. Është pikërisht Plani i Veprimit në zbatim të kësaj strategjie, dokumenti në të cilin përmbledhen të gjitha aktivitetet dhe masat në përmbushje të objektivave strategjike. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është një nga institucionet e përfshira në këtë plan masash. Aktualisht, Plani i Veprimit në zbatim të SELP është hartuar dhe pritet të miratohet pas procesit të konsultimit publik.

Në këtë plan janë parashikuar disa masa konkrete që synojnë të mbështesin dhe informojnë komunitetet rome dhe egjiptiane në përputhje me nevojat e tyre. Konkretisht, DNJF ndër të tjera, është përgjegjëse për masat nën objektivin specifik 4.1: Rritja e aksesit të publikut në informacionin ligjor dhe pasurimi i vazhdueshëm i njohurive juridike të tyre në përputhje me nevojat specifike. Në zbatim të tij janë parashikuar disa masa si: kryerja e një vlerësimi mbi nevojat prioritare dhe imediate të qytetarëve për edukim ligjor, sesione / broshura informuese, manual mbi sistemin e ndihmës juridike si dhe aktivitete/seminare ndërgjegjësuese.

Është shumë e rëndësishme që këto aktivitete ndërgjegjësuese të vijojnë në mënyrë të pandërprerë në çdo qytet. Kjo natyrisht zhvillohet në bashkëpunim me të gjitha institucionet përgjegjëse për dhënien e ndihmës juridike sidomos me ato të ndihmës juridike parësore ku qendrat e ofrimit të ndihmës juridike dhe sidomos OJF-të e autorizuar luajnë një rol thelbësor në këtë fushë.

10.3 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND)

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është një nga institucionet që garanton aksesin në drejtësi dhe si e tillë ka një kontribut të rëndësishëm në këtë strategji dhe në zbatimin e saj përmes planit të veprimit. Gjatë kësaj periudhe DNJF është angazhuar në raportim mbi masat e parashikuara në planin aktual të veprimit në zbatim të kësaj strategjie si dhe me kontribut e sugjerime konkrete mbi procesin e rishikimit të strategjisë që pritet të fillojë së shpejti. Konkretisht, kemi dhënë sugjerime pa filluar ende procesin, ndalur konkretisht si vijon: *Duke qënë një institucion kyç lidhur me aksesin në drejtësi, përfshirja e këtij institucioni duhet të konkretizohet në një objektiv strategjik të strategjisë. Në planin aktual DNJF është përgjegjës për një nën-objektiv që lidhet me aksesin në drejtësi, i cili është pjesë e objektivit 3 të strategjisë. Tashmë, me rishikimin e këtij dokumenti, mund të ndiqet e njëjta logjikë e ndarjes në nën objektiva dhe të parashikohen në vetë strategjinë si të tillë jo vetëm në plan veprim ose mund të ndiqet logjika e rishikimit të objektivave dhe rikonceptimit e rigrupimit të tyre duke marrë parasysh edhe shtim të ndonjë objektivit tjetër nëse shikohet e nevojshme.*

10.4 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 (SNKK)

DNJF ka dhënë kontribut në kuadër të zbatimit të planit të veprimit të strategjisë, konkretisht për masën e lidhur me veprimtarinë Task Forcës Antikorrupsion (nën objektivin A.8 të strategjisë). Në funksion të **objektivit A.8** të strategjisë, konkretisht *masa A.8.4*: “*Kontrolli dhe verifikimi (hetimi administrativ) i zbatimit të ligjshmërisë dhe/ose denoncimeve për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare në të gjitha institucionet e administratës publike dhe agjencitë, për zbatimin e së cilës janë përgjegjës/raportues të gjitha institucionet*”.

Për DNJF është caktuar një person përgjegjës që do të ndjekë zhvillimet dhe kontributet në këtë kuadër lidhur me raportime të vazhdueshme për zbatueshmërinë e kësaj mase.

(Pikë kontakti Xh.Mulla).

10.5 Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë për të Miturit

Qëllimi i Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit 2017-2020 në Republikën e Shqipërisë është promovimi dhe mbrojtja më efektive e të drejtave dhe nevojave në proceset gjyqësore dhe alternativat ndaj këtyre procedurave, për të miturit në konflikt me ligjin, viktima, dëshmitar të veprave penale, të miturit nën moshë për tu ndjekur penalisht dhe të miturit pjesëmarrës në proceset gjyqësore administrative apo civile, nëpërmjet implementimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të së drejtave të fëmijëve.

Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” i ka parashikuar të miturit si kategori të veçanta përfituese. Siç paraqitet në aspektin penal, si në çështjet civile ashtu edhe në atë administrative, të miturit në konflikt me ligjin garantohej nga një numër i të drejtave procedurale dhe garancive sipas parashikimeve të ligjit nr. 111/2017.

DNJF ka dhënë kontribut në kuadër të zbatimit të planit të veprimit të strategjisë si dhe po vijon t’i kushtojë një vëmendje të shtuar të miturve, si kategori të veçanta përfituese përmes aktiviteteve të ndryshme të edukimit ligjor (cituat në kalendarin e aktiviteteve bashkëlidhur këtij raporti)

10.6 Dokumente të tjera strategjike në të cilat është DNJF është angzhuar, konkretisht:

- Hartimi i dokumentit IPA III për fushën e EU justice and fundamental rights;
- Kontribut në kuadër të Strategjisë së Barazisë Gjinore dhe Planit të Veprimit 2016-2020, për periudhën janar-dhjetor 2019

11.Dhënie Kontributi në Kuadër të Raportimeve, Grupeve të Punës Kombëtare/Ndërkombëtare

- *Dhënia e kontributit në kuadër të raportit të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)*

Pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është administruar shkresa e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, përmes së cilës përcillet raporti i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) . Referuar shkresës së sipërcituar, në kuadër të gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit, kërkohej përcjellja e kontributit brenda fushës së përgjegjësive institucionale të çdo autoriteti përgjegjës. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në cilësinë e institucionit përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike, pasi e analizoi me kujdes këtë raport dhe rekomandimet e tij, e vlerësoi të nevojshme përcjellen e disa komenteve mbi ecurinë e sistemit të ndihmës juridike falas në Republikën e Shqipërisë.

- *Dhënia e kontributit në kuadër të Planit Shtesë nderinstitucional për veprimin për pritjen dhe trajtimin e shtetasve shqiptar që kthehen nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak*

DNJF në kuadër të urdhrimit të Kryeministrit nr. 148, datë 05.11.2019, mbi “Planin Shtesë nderinstitucional për veprimin për pritjen dhe trajtimin e shtetasve shqiptar që kthehen nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak”, është angazhuar në hartimin e planit të masave si dhe adresimin e rasteve për ndihmë juridike që kanë hasur këta shtetas duke i adresuar pranë Qendrave të Ofrimit të Ndhmës Juridike si dhe ndjekjes së ecurisë së rasteve.

- *Dhënia e kontributit në kuadër të raportimit për CEPEJ European Commission for the Efficiency of Justice) CEPEJ*

Në kuadër të projektit të bashkëpunimit me Komisionin Evropian - Treguesit e Ballkanit Perëndimor

- *Qëndrim mbi raportin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit mbi sistemin e ndihmës juridike parësore me ndryshimet e ligjit 111/2017*

Pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, janë përcjellë raportet e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, me lëndë: “Monitorimi i zbatimit të ligjit..për ndihmën juridike të garantuar nga shteti në kuadër të ofrimit të ndihmës Juridike parësore”. Përmes këtyre raporteve janë përcjellë gjetjet kyçe dhe rekomandimet përkatëse të cilat duhet të merren parasysh nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e ndihmës juridike. DNJF i analizoi me kujdes gjetjet e parashtruara në këto raporte duke i parë në një vështrim krahasues me hapat e ndërmarra nga ana e institucionit tonë dhe në përfundim, e vlerësoi të nevojshme përcjelljen e një qëndrimi në lidhje me komentet dhe rekomandimet e pasqyruara

- *Raportim i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas mbi Raportin e pestë Kombëtar mbi zbatimin e Konventës së OKB-së “Për eliminimin e të gjithave formave të Diskriminimit ndaj Grave” (CEDAË).*

Dhënia e një informacioni mbi zhvillimet kryesore, arritjet, por edhe veshitësitë dhe sfidat e hasura për zbatimin e dispozitave dhe rekomandimeve specifike për garantimin dhe ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore të grave, bazuar në gjinore dhe mosdiskriminimit

- *Dhënia e kontributit referuar planit kombëtar të veprimit për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve*

Në kuadër të procesit të integritit të Shqipërisë në BE me vendim të Këshillit të Ministrave nr.1072,date 23.12.2015 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve,2016-2020 ”përcaktohen politikat specifike dhe masat konkrete që institucionet përgjegjëse do të ndërmarrin ne realizimin e objektivave që synojnë të përmirësojnë jetesën e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri.Përmes këtij plani kombëtar të veprimit sipas fushave të politikës përcaktohen institucionet përgjegjëse,masat dhe indikatorët në përgjegjësinë e Drejorisë së Ndhmës Juridike Falas mbi të cilat është dhënë kontribut.

- *Dhënia e kontributit në kuadër të Raportit të Monitorimit mbi Zbatimin e Planit të Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018– 2020*

Duke e lidhur fushëveprimin e DNJF me objektivin konkret te PV: “*Forcimi i mekanizmave për mbrojtjen e viktimave në të gjithë zinxhirin e drejtësisë penale (qasja, aksesit në drejtësi)*”: rezulton se:Ligji nr.111/2017, “Per ndihmen juridike te garantuar nga shteti”, parashikon viktimat e trafikimit si nje nga subjektet drejtperdrejt perfituese nga sherbimet juridike falas, pavaresisht te ardhurave financiare te tyre;DNJF gjithashtu, ka parashikuar ne planin e punes per vitin 2020 nje sere aktiviteteesh ndergjegjesuese te cilat do te kene fokus grupet e vecanta, kategorite vulnerabel te parashikuara ne ligj (nje nder to dhe viktimat e trafikimit);Gjithashtu, vijon bashkepunimi me DhASh per perfshirjen ne kurrikulat e trajnimit, kategorite e vecanta te ligjit per trajnimin e ofruesve te sherbimit te ndihmes juridike.

12. Përcjellja e qendrimeve mbi studimet e kryera nga organizata ndërkombëtare në kuadër të sistemit të ndihmës juridike falas

- *Manuali “The new Law on legal Aid” EURALIUS*

Manuali ka formën e një komentari të detajuar të ligjit 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” parë në këndvështrimin teorik dhe praktik. Botimi I një komentari të tillë është mjaft I vlefshëm për DNJF por edhe për ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Drafti është komentuar nga ana jonë vetëm në ato pjesë që lidheshin me ecurinë e hapjes që qendrave; bashkëpunimit me klinikat e ligjit dhe procedurës së autorizimit të OJF-ve, duke qenë se këto zhvillime kanë pësuar ndryshime të vazhdueshme.

- *NOTE on national capacities for primary legal aid service delivery*

Qëllimi i këtij studimi është të mbështesë Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas në organizimin, administrimin dhe shpërndarjen e ndihmës juridike parësore. Në mënyrë të përmbledhur, ky draft studim konsiston në gjetje dhe përfundime nga një pyetësor i realizuar OJF-të që ofrojnë ndihmë juridike parësore (8 OJF pjesëmarrëse) Studiimi jep të dhëna mbi stafin administrativ të këtyre organizatave; trajnimet e tyre; numrin mesatar të rasteve të trajtuara dhe kohëzgjatja mesatare e një rasti si dhe llojet me të përhapura të çështjeve duke u konkluduar me një hartë të shpërndarjes gjeografike duke cilësuar qytetet të cilat kanë mungesa për sa i përket OJF-ve që ofrojnë ndihmë juridike parësore.

- *Studimi “Vlerësimi i Nevojave Ligjore dhe aksesit në drejtësi në Republikën e Shqipërisë” përgatitur nga Albanian Liberal Institute*

Pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, është përcjellë draft studimi i Albanian Liberal Institute mbi “Nevojat Ligjore dhe aksesit në drejtësi në Republikën e Shqipërisë”. Ky studim i kryer përmes formave të ndryshme statistikore u ndërmor për analizuar llojin e problemeve juridike me të cilat përballet popullata shqiptare, njohuritë e qytetarëve shqiptarë në zgjidhjen e problematikave ligjore, mënyrat sesi ata reagojnë ndaj problemeve si dhe perceptimet mbi efektivitetin e sistemit gjyqësor në Shqipëri.

Studimet mbi nevojat ligjore të qytetarëve, të identifikuar këto përmes realizimit të anketave e sondazheve konkrete, janë të rëndësishme dhe i shërbejnë Ministrisë së Drejtësisë në hartimin e politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike. Gjithashtu, studime të tilla kanalizojnë drejt edhe trajnimet që zhvillohen në fushën e ndihmës juridike për ata që do të ofrojnë këtë shërbim. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, duke patur parasysh se cilat janë nevojat ligjore konkrete të qytetarëve në Shqipëri, parashikon trajnime të posaçme në këto fusha prioritare për juristët që e ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore si dhe bashkëpunon me DhASH për trajnimin e avokatëve të ndihmës juridike dytësore.

Gjetjet e këtij studimi u analizuan nga stafi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe në mënyrë të koncentruar po parashtrijmë disa nga statistikatat të cilat janë të lidhura ngushtësisht me sistemin e ndihmës juridike falas dhe detyrimin që kanë të gjithë institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike në rritjen e aksesit në drejtësi.

13. Analiza të drejtorisë së ndihmës juridike falas

- *Analizë e Ligjit 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” si dhe e akteve nënligjore të dala në zbatim të tij*

Qëllimi i këtij punimi është analiza e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti duke u ndalur në Ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji. Në këtë punim është përdorur një metodologji e caktuar ku ndërthuren disa teknika.

Metoda e Analizës së Legjislacionit: Nëpërmjet metodës së analizës dhe sintezës është bërë e mundur identifikimi i problemeve ligjore, dhënia e një interpretimi shkencor të dispozitave që e rregullojnë të dëmtuarin sipas qëllimit të ligjvënësit. Në këtë mënyrë janë identifikuar paqartësitë, mangësitë ligjore dhe është dhënë një zgjidhje e mundshme nëpërmjet rekomandimeve dhe sugjerimeve të ndryshme referuar dispozitave konkrete.

Metoda përshkruese: Kjo metodë është përdorur për të shpjeguar nocionet e ndryshme që gjenden në legjislacionin për t’u dhënë atyre një kuptim sa më të saktë. Në këtë punim janë shpjeguar nocione si: ndihmë juridike parësore, ndihmë juridike dytësore, këshillim, qëndër shërbimi e ndihmës juridike parësore, punonjës më trajnim të posaçëm, klinikë ligjore, përjashtim nga tarifatat dhe shpenzimet gjyqësore.

Metoda krahesuese: Në punim janë krahesuar Ligji në fuqi për ndihmën juridike dhe sistemi që parashikon ky ligj në raport me Ligjin e mëparshëm për ndihmën juridike duke sjellë kështu një pasqyrë të ndryshimeve të reja dhe problematikave të hasura me rregullimin e mëparshëm.

Kërkimi Doktrinor: Një ndër metodat e përdorura në këtë punim është ajo e kërkimit doktrinor, nëpërmjet përdorimit të të cilit është bërë e mundur identifikimi, mbledhja dhe shfrytëzimi i literaturës juridike në këtë fushë duke u ndalur tek tekstet e së drejtës.

Metoda e Analizës së Praktikës Gjyqësore: Zbatimi në praktikë i normave të së drejtës dhe interpretimi i tyre gjyqësor përbëjnë një tjetër metodë kërkimi të këtij punimi. Nëpërmjet kësaj metode është bërë e mundur identifikimi i vendimeve gjyqësore (kryesisht vendime të GjEDNj dhe Gjykatës Kushtetuese), që kanë trajtuar çështje gjyqësore që kanë të bëjnë me “aksesin në drejtësi”.

- *Analizë mbi tarifën e ekspertëve në procesin gjyqësor*

Analiza ka për objekt vlerësimin e tarifave të ekspertëve në procesin gjyqësor, me qëllim evidentimin e problematikave që mund të shoqërojnë zbatueshmerinë e ligjit nr.111/2017, sa i përket ndihmës juridike dytësore, në përjashtimin e palëve nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, si dhe mënyrën e funksionimit të gjykatave lidhur me garantimin e këtij elementi të ndihmës juridike falas. Gjithashtu, një krahasim i skemave kombëtare evidenton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të sistemeve të ndihmës juridike të financuara nga shteti.

- *Analizë e detajuar e Urdhrit nr. 531, datë 25.11.2019, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”*

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas, si institucioni përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti është e ngarkuar me funksionin mbikëqyrës të cilësisë së shërbimeve juridike që ofrohen nga subjektet e përcaktuara në ligj. Referuar nenit 8 të Ligjit nr.111/2017,(pika I dh II), Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas zbaton sistemin e vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike dhe mbikëqyr çdo vit standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët. Në zbatim të këtyre parashikimeve, me Urdhërin nr. 534, datë 25.11.2019, “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”, është miratuar metodologjia që do të ndiqet për të vlerësuar dhe mbikëqyrur cilësinë e shërbimeve të ofruara të ndihmës juridike.

Ky dokument shpjegon nocionin e ndihmës juridike, referuar ndihmës juridike parësore dhe dytësore, shërbimet që përfshin secila ndarje, qëllimet që ndjek ndihma juridike referuar ligjit 111/2017, metodologjinë e vlerësimit dhe procedurat e mbikëqyrjes dhe koordinimit të cilat janë shpjeguar në mënyrë të detajuar nëpërmjet kësaj analize.

- *Analizë mbi tarifën e avokateve që ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti*

Duke qenë se në kuadër të përcaktimeve të ligjit 111/2017, pagesa e avokatëve dhënës të ndihmës juridike dytësore, kryhet nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, është proceduar me kryerjen e një analize financiare të aftësisë paguese të Drejtorisë pasi kjo gjë lidhet drejtëpërdrejtë me numrin e rasteve të cilat mund të mbështeten me buxhetin e shtetit e cila sjell si pasojë kufizimin e dhënies “de facto” të ndihmës juridike dytësore për qytetarët përfitues. Analiza i është përcjellë Ministrisë së Drejtësisë me qëllim reflektimin e saj në tryezat e zhvilluara me pëfaqësues të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë në kuadër të miratimit 2 të akteve nënligjore mbi tarifatat dhe rotacionin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore.

KREU II- RAPORTIMI DHE MENAXHIMI FINANCIAR

Në zbatim të ligjit nr.88/2019 “Për buxhetin 2020, datë.18.12.2019, në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe në zbatim të kompetencave të parashikuara në nenin 8, pika b) *DNJF i paraqet Ministrinë të Drejtësisë raporte tremujore mbi zbatimin e këtij ligji dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike; dhe ç) menaxhon fondet buxhetore për dhënien e ndihmës juridike*, DNJF:

- ✓ ka raportuar Ministrinë të Drejtësisë mbi realizimin e zërave të buxhetit për vitin 2020;
- ✓ ka hartuar Rregjistrin e Riskut të DNJF për vitin 2020;
- ✓ ka paraqitur Ministrinë të Drejtësisë dhe Degës së Thesarit Tiranë raporte mujore për përdorimin e buxhetit të DNJF;
- ✓ ka paraqitur Ministrinë të Drejtësisë projekt-buxhetin afatmesëm të DNJF për vitin 2019-2021;
- ✓ ka paraqitur Ministrinë të Drejtësisë raportimin çdo 3 muaj për monitorimin e shpenzimeve buxhetore për vitin 2020;
- ✓ ka hartuar rregjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2020 dhe ia ka raportuar Ministrinë të Drejtësisë dhe Degës së Thesarit Tiranë;
- ✓ marrjen e masave për zbatimin e kontratës së grantit Nr. 8331 për hapjen e Qendrave e Ndihmës Juridike Parësore Tiranë, Elbasan.

Zbatimi i buxhetit në kohë dhe në respektim të përcaktimeve/detyrimeve ligjore, përveçse një faktor orientues, është edhe një instrument stimulues për aktivitetin ekonomik nëpërmjet ekzekutimit të shpenzimeve publike. Realizimi me efektivitet i shpenzimeve buxhetore të programit, tregon një pasqyrë të saktë të shpenzimeve të realizuara.

Në fund të muajit qershor nga ana e drejtorisë është dërguar shkresë Ministrisë së Drejtësisë me objekt, “Miratim për procedurën e ambjenteve të reja” sipas porosisë së Sekretarit të Përgjithshëm.

Gjithashtu me sukses u arrit dhe disbursimi i fondit faza e dyte nga Fondacioni Shoqëria e hapur për Shqipërinë, sipas kontratës nr.8331.


Pas rishikimeve të buxhetit nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në zërin e shpënzimeve operative u pakësuan me nje vlerë prej 63 milion lekësh, ky pakësim do të krijojë shumë vështirësi në performacën e drejtorisë, për të qënë sa më në koherencë me politikat dhe objektivat e Ministres.

Ent. Qev.	Min Linjës	Kodi Instit	Emër Institucioni	Kap	Program	Llogaria Ekonomike	Kodi i D. Thesarit	Kod Produkti	Emertimi Produktit	ne leke. VITI 2020
			TOTALI						PAKESOHET	6,300
014	06	03310	Drejtoria e Ndhimes Juridike Falas	01	01140	602000	3535		Mallra dhe Sherbime	6,300

Te tjera transferta per institucionet jo-fitim prurese:

Në buxhet pjesë është dhe zëri i transfertave për institucionet OJF, ku drejtoria ka përfunduar fazën e shqyrtimit të dosjeve në fazën e parë.

Për periudhën e mbetur fondet e disponueshme rezultojnë të jenë:



Paga Shpërblime -14.837.575

Sigurime Shoqëre dhe Shëndetsore -2.473.953

Mallra dhe Shërbime – 14.000.530

Transferime Korrente Te Brendshme -8.000.000

KREU III- PROBLEMATIKAT DHE SFIDAT PËR TË ARDHMEN

Problematikat

✚ Plotësimi i organikës së DNJF

Parimi i hierarkisë është një nga parimet më të rëndësishme për sa i përket organizimit dhe funksionimit të institucioneve të administratës shtetërore. Koordinimi dhe orientimi i stafit nga ana e një drejtuesi është thelbësor në mbarëvarjen e punës në mënyrë efçente. Si pasojë, mungesa e stafit drejtues për një periudhë kaq të gjatë, ka qenë një sfidë për stafin e DNJF.

✚ Pezullimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere/ edukimit ligjor të publikut të planifikuara për t'u zhvilluar nga DNJF në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike falas.

DNJF, në këtë situatë të jashtëzakonshme në të cilën ndodhemi për shkak të Covid-19, pavarësisht detyrave të saj funksionale të një natyre të veçantë, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me qytetarët (gjë që bie ndesh me masat shtrenguese të ndërmarra për mos zhvillimin e takimeve/aktiviteteve publike), ka vijuar me veprimarinë e saj në kuadër të përmbushjes së qëllimit kryesor: rritjes së aksesit në drejtësi të qytetarëve përmes ofrimit të ndihmës juridike falas. Por, nuk mund të mohojmë se një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve të planifikuar janë detyruar të pezullohen për shkak të masave të distancimit fizik. Kjo gjë ka ndikuar në veprimtarinë dhe progresin e DNJF sa i përket rritjes së ndërgjegjësimit mbi sistemin e ndihmës juridike falas.

Sfidat

SFIDAT me qëllim zhvillimin dhe promovimin e sistemit të ndihmës juridike sfidat e rëndësishme për periudhat janë:

- ✦ Ngritja e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në qytetet e planifikuara duke synuar shtrirjen e shërbimit të ndihmës juridike parësore në të gjithë territorin e vendit;
- ✦ Promovimi sa më shumë i sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti duke synuar ndërgjegjësimin dhe si rrjedhojë rritjen e numrit të kërkesve për ndihmë juridike;
- ✦ Bashkëpunim më proaktiv ndërmjet institucioneve që përfshihen në sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti;
- ✦ Forcimi i bashkëpunimit të mëtejshëm me organizata të shoqërisë civile dhe donatorë të ndryshëm për të zhvilluar aktivitete dhe projekte të përbashkëta;
- ✦ Rritja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përmes mbikëqyrjes dhe monitorimit të vazhdueshëm nga DNJF.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

NDIHMA JURIDIKE E GARANTUAR NGA SHTETI
TË DHËNA STATISTIKORE

Janar – Qershor 2020

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike ka si mision garantimin e aksesit të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë nëpërmjet ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Si një institucion kyç, dedikuar garantimit dhe ofrimit të ndihmës juridike falas përmes administrimit dhe funksionimit të sistemit të ndihmës juridike, DNJF bashkëpunon dhe ndërvepron me organet e parashikuara në ligj si aktorë kyç në dhënien e ndihmës juridike.

NDIHMA JURIDIKE PARËSORE

Ndihma juridike parësore është një nga format e ofrimit të ndihmës juridike, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 111/2017. *Ndihma juridike parësore konsiston në:* Dhënien e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor; dhënie e këshillimit; Dhënie e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve; Dhënie e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore; Përfaqësim përpara organeve administrative; dhe dhënie e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Ofruesit e ndihmës juridike parësore janë:

- a) punonjësit me trajnim të posaçëm; (të punësuar pranë Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore);
- b) nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara;
- c) nga klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë

DNJF është aktualisht në proces të lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit në Institucionet e Arsimit të Lartë, për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.

Gjithashtu, procedura për autorizimin e OJF-ve që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti është në proces dhe pritet të përfundojë brenda muajit qershor 2020.

Nisur nga ky fakt, *të dhënat statistikore për ndihmën juridike parësore të garantuar nga shteti do të përqëndrohen në shifrat e prodhuara nga qendrat e ndihmës juridike parësore të administruara nga Ministria e Drejtësisë.* Aktualisht janë hapur dhe funksionojnë këto qendra të ndihmës parësore: Tiranë, Elbasan, Durrës, Fier dhe Lezhë. Statistikat e gjeneruara nga këto qendra do të përkojnë me kohën e hapjes së tyre. *(Qendra Tiranë ka qënë funksionale që në vitin 2017 dhe ka funksionuar si zyrë ligjore e aktualisht funksionon si qender; Qendra Elbasan është hapur në tetor 2019 dhe Qendra Durrës / Fier dhe Lezhë janë hapur në 2020).*

QENDRA E OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE TIRANË

Të dhëna statistikore	
2020	
Ofrim të ndihmës juridike parësore / këshillim ligjor /informacion	Keshillim ligjor dhe asistencë në përpilimin e dokumentave për ndihmë juridike dytësore
311	12
TOTALI I RASTEVE TË TRAJTUARA = 323	

QENDRA E OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE ELBASAN

Të dhëna statistikore	
2020	
Ofrim të ndihmës juridike parësore / këshillim ligjor /informacion	Keshillim ligjor dhe asistencë në përpilimin e dokumentave për ndihmë juridike dytësore

13	10
TOTALI I RASTEVE TË TRAJTUARA = 23	

**QENDRA E OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE
DURRËS**

Të dhëna statistikore	
2020	
Ofrim të ndihmës juridike parësore / këshillim ligjor /informacion	Keshillim ligjor dhe asistencë në përpilimin e dokumentave për ndihmë juridike dytësore
129	-
TOTALI I RASTEVE TË TRAJTUARA = 129	

**QENDRA E OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE
FIER**

Të dhëna statistikore	
2020	
Ofrim të ndihmës juridike parësore / këshillim ligjor /informacion	Keshillim ligjor dhe asistencë në përpilimin e dokumentave për ndihmë juridike dytësore
73	14

TOTALI I RASTEVE TË TRAJTUARA = 87	

**QENDRA E OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE
LEZHË**

Të dhëna statistikore	
2020	
Ofrim të ndihmës juridike parësore / këshillim ligjor /informacion	Keshillim ligjor dhe asistencë në përpilimin e dokumentave për ndihmë juridike dytësore
147	
TOTALI I RASTEVE TË TRAJTUARA = 147	

NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE

Ndihma juridike dytësore është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.

Ndihma juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, Ligjit nr.111/2017. Kërkesa hartohet sipas formularit të kërkesës, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë

Më Poshtë është pasqyruar numri i vendimeve gjyqësore me objekt ndihmën juridike të komunikuar nga gjykatat për vitin 2019 – 2020. Për vitin 2019 të dhënat përkojnë me periudhën e krijimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas (drejtoria është krijuar në mars dhe vendimet kanë ardhur pranë

DNJF nga muaji maj e në vijim). Për vitin 2020 të dhënat janë llogaritur deri në muajin prill (Totali në shtojcën bashkëlidhur këtij dokumenti), por për efekt informacioni më poshtë është vendosur tabela dhe për muajin maj deri aktualisht.

STATISTIKA PËR VITIN 2020

<i>Vendime Gjyqësore me Objekt Ndihmën Juridike</i>			
<i>Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore</i>	<i>Rrëzim të kërkesës për ndihmë juridike</i>	<i>Pranim të kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>
38	11	9	4
<i>Totali i Vendimeve Gjyqësore = 62</i>			

NDIHMA JURIDIKE ONLINE

Në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e pandemisë (Covid-19), u mbyllën qendrat e ndihmës parësore, dhe një pjesë e procesve të punës u pezulluan. Duke qënë një shërbim ngushtësisht i lidhur me qytetarin, kurrësesi ndihma juridike nuk mund të mos ofrohej dhe në këto kushte kufizimi. Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka vijuar me ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes platformës juristionline.al. Në këtë platformë janë angazhuar dhe ofrojnë ndihmë juridike parësore juristët / avokatët e qendrave të ndihmës parësore.

Të dhëna statistikore (23.3.2020 – 30.6.2020)
Platforma www.juristionline.al
Ofrim të ndihmës juridike parësore / këshillim ligjor / informacion
574
TOTALI I RASTEVE TË TRAJTUARA = 574

NUMRI JESHIL 08001010

Të dhëna statistikore

(22.5.2020 – 03.07.2020)

Ofrim të ndihmës juridike parësore / këshillim ligjor /informacion

TOTALI I RASTEVE TË TRAJTUARA = 131 telefonata

Shtojcë

STATISTIKA NË TOTAL

JANAR - QERSHOR 2020

NDIHMA JURIDIKE PARËSORE

Të dhëna në TOTAL për rastet e trajtuara nga qendrat e ndihmës parësore

(Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier dhe Lezhë)

Të dhëna statistikore	
2020	
Ofrim të ndihmës juridike parësore / këshillim ligjor /informacion	Keshillim ligjor dhe asistencë në përpilimin e dokumentave për ndihmë juridike dytësore
673	36
TOTALI I RASTEVE TË TRAJTUARA = 709	

NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE

TOTALI i vendimeve gjyqësore me objekt ndihmën juridike

<i>Vendime Gjyqësore me Objekt Ndhmën Juridike</i>			
<i>Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore</i>	<i>Rrëzim të kërkesës për ndihmë juridike</i>	<i>Pranim të kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>

38	11	9	4
<i>Totali i Vendimeve Gjyqësore = 62</i>			

NDIHMA JURIDIKE ONLINE

Të dhëna statistikore ((23.3.2020 – 30.6.2020)
Platforma www.juristonline.al
Ofrim të ndihmës juridike parësore / këshillim ligjor /informacion
574
TOTALI I RASTEVE TË TRAJTUARA = 574

NUMRI JESHIL 08001010

Të dhëna statistikore (22.5.2020 – 03.07.2020)
Ofrim të ndihmës juridike parësore / këshillim ligjor /informacion
TOTALI I RASTEVE TË TRAJTUARA = 131 telefonata

ANNEX

FREE LEGAL AID STATISTICS

January – June 2020

PRIMARY LEGAL AID

Statistical Data for cases handled by primary legal aid centers

(Tirana, Durrës, Elbasan, Fier and Lezha)

Statistical data 2020	
<i>Providing of primary legal aid / counselling / legal information</i>	<i>Counselling and the compilation of the necessary legal acts for putting in motion the court</i>
673	36
TOTAL CASES = 702	

SECONDARY LEGAL AID

TOTAL of court decisions with the object of legal aid

<i>Court Decisions with the object of Legal Aid</i> <i>Since the establishment of the FLAD - March 2019 – May 2020</i>			
<i>Approval of the request for secondary legal aid</i>	<i>Dismissal of the request for secondary legal aid</i>	<i>Approval of the request for exemption from payment of court fees and other court costs</i>	<i>Approval of the request for secondary legal aid and exemption from payment of court fees and other court costs</i>

38	11	9	4
<i>TOTAL of Court Decisions = 62</i>			

ONLINE LEGAL AID

www.juristionline.al Platform

Statistical Data (23.3.2020 – 31.5.2020)	
<u>www.juristionline.al</u> Platform	
<i>Providing of primary legal aid / counselling / legal information</i>	<i>Counselling and the compilation of the necessary legal acts for putting in motion the court</i>
398	-
TOTAL CASES = 398	

GREEN NUMBER 0800 1010

Statistical Data
<i>(22.5.2020 – 03.07.2020)</i>
<i>Providing of primary legal aid / counselling / legal information</i>
TOTAL CASES = 131 Calls

Material përmbledhës me disa zhvillime kryesore të javës së parë të muajit korrik

✦ TAKIMI ME DONATORET (UNDP EURALIUS, SOROS) PER PROJEKTET ON GOING

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, që nga fillimi i funksionimit të saj ka patur një mbështetje të vazhdueshme nga ana e donatorëve, në kuadër të forcimit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Konkretisht, UNDP, EURALIUS dhe OSFA, përmes projekteve të përbashkëta kanë bashkëpunuar vazhdimisht me drejtorinë, bashkëpunim i cili ka rezultuar i frytshëm dhe efektiv.

Në vijim, gjeni një përmbledhje të disa takimeve që Drejtoria ka zhvilluar me partnerët mbështetës. Konkretisht, takimet konsistojnë si vijon:

- Bashkëpunimi me UNDP

UNDP është një ndër partnerët kryesorë mbështetës të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas me mbështetjen e të cilit janë hapur 2 qendra të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në qytetin e Lezhës, Fierit dhe Durrësit.

Ky bashkëpunim është shtrirë edhe më tej, në kushtet kur në kuadër të projektit të bashkëpunimit që UNDP ka me Ministrinë e Drejtësisë: “*Mbështetje për të forcuar kapacitetet institucionale të Ministrisë së Drejtësisë Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (MD / DNJF) në zbatimin e kompetencave të saj për të administruar shërbimin e ndihmës juridike parësore të ofruar*” janë planifikuar që brenda vitit 2022, të hapen 5 qendra të reja. , sipas “Standard letter of agreement” midis UNDP dhe Ministrisë së Drejtësisë në kuadër të implementimit të projektit mbi zgjerimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri.

Në këtë kuadër, më datë 07.7.2020, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, z. Qirici zhvilloi një takim me përfaqësues nga UNDP në të cilin u diskutua mbi projektin e bashkëpunimit. Gjatë këtij takimi u diskutua në terma konkretë mbi:

- Ecurinë e hapjes së qendrave të reja në funksion të shtrirjes së shërbimit të ndihmës juridike parësore;
- Mbështetjen në drejtim të forcimit të kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore përmes zhvillimit të trajnimeve në fusha specifike të lidhura me kategoritë vulnerabël.

Mbështetjen lidhur me promovimin e sistemit të ndihmës juridike falas përmes ndërgjegjësimit dhe informimit të qytetarëve.

Në përfundim të këtij takimi përfaqësuesit e DNJF dhe UNDP, shprehën vullnetin e tyre për vijimin e bashkëpunimit të ngushtë përmes zhvillimit të takimeve të shpeshta dhe periodike me qëllim implementimin e aktiviteteve të sipërpërmendura.

- Bashkëpunimi me Euralius

Një ndër partnerët mbështetës të drejtorisë në kuadër të çështjeve të ndihmës juridike falas është EURALIUS, i cili ka parashikuar 2 aktivitete kryesore të lidhura me fushëveprimtarinë e drejtorisë, si vijon:

- 1.4.1: Mbështetje Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera në organizimin, administrimin dhe shpërndarjen e ndihmës juridike parësore dhe dytësore;
- 1.4.2: Mbështetje në krijimin dhe forcimin e kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera/organizatave të përfshira në administrimin dhe dhënien e ndihmës juridike.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve EURALIUS është angazhuar në mbështetje të Drejtorisë së Ndihmës Juridike si vijon:

1. Hartimi i një Strategjie për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti

Objektivi madhor i kësaj strategjie është: *“Përmirësimi dhe rritja e aksesit në drejtësi për grupet vulnerabël në kuadër të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore të garantuar nga shteti në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë”*. Në këtë strategji do të parashikohen disa objektiva strategjike në përbushje të të cilëve do të hartohet një plan konkret veprimi.

Në kuadër të zhvillimit të strategjisë 5 veçare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas zhvilluar në janë zhvilluar në vijimësi një sërë takimesh online që prej datës 20 Maj 2020, ku përfaqësuesit e DNJF kanë ndjekur dhe kanë dhënë kontributin e tyre për çdo fazë të hartimit të strategjisë sipas pikave të përcaktuara nga EURALIUS (pjesë e aktivitetit 1.4.1) si vijon:

1. Takimi i parë në kuadër të hartimit të strategjisë kishte për qëllim të shpjegonte procesin e hartimit të strategjisë së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe rëndësisë që ka ky dokument strategjik për funksionimin e sistemit të ndihmës juridike falas;
2. Ky takim u pasua nga takimi i dytë ku Euralius dhe përfaqësuesit e DNJF diskutuan mbi procesin e parë të strategjisë SWOT Analysis ku përmbahen të dhëna lidhur me (Strengths; Solutions; Threats dhe Opportunities)
3. SWOT analysis u pasua me procesin e dytë në kuadër të hartimit të strategjisë (Problem tree dhe Solution tree);
4. Problem tree dhe solution tree u pasua me krijimin e një “Log Frame” (që përbën strukturën që do të ketë strategjia e DNJF)

Së fundmi, në takimin e datës 07/07/2020, përveç se u zhvillua një prezantim i Drejtorit të Përgjithshëm z. Qirici me përfaqësit e Euralius që janë të angazhuar në këtë proces, u vijua me një prezantim të përgjithshëm mbi ecurinë e hartimit të strategjisë.

Diskutimet u ndalën kryesisht në pjesën e buxhetit që do të duhet të alokohet në funksion të implementimit dhe zbatimit të kësaj strategjie 5 vjeçare. Nga ana e përfaqësuesve të Euralius u sugjerua që të parashikohen të gjitha aktivitetet e nevojshme në zbatim të objektivave strategjike (të shoqëruara me vlerën e kostos përkatëse) si një mënyrë shumë e mirë për të parashtruar qartë nevojat që ka sistemi i ndihmës juridike. Pjesa e buxhetit (pamjaftueshmëria e buxhetit) është një çështje që do të shtrohet për diskutim pasi të jenë parashtruar të gjitha nevojat, reflektuar këto të fundit në hartimin e strategjisë dhe planit konkret të veprimit.

Në përfundim, u vendos që do të punohet nga ana e përfaqësuesve të Euralius me hartimin e strategjisë bazuar mbi punën e bërë deri aktualisht (duke bashkëpunuar ngushtësisht me stafin e DNJF), dhe do të dërgohet drafti i parë i strategjisë. Pas vlerësimit të këtij drafti nga i gjithë grupi i punës do të vijohet edhe me hartimin e planit të veprimit 2020-2025 në zbatim të kësaj strategjie.

2. CMS (Case Management System)

Gjithashtu, në kuadër të aktiviteteve të sipërcituara, **EURALIUS ka parashikuar si nën-aktivitet edhe propozimin mbi krijimin e CMS (Case Management System), për ndihmën juridike.**

Qëllimi i këtij sistemi është administrimi i të dhënave nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për sa i përket rasteve të trajtuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike falas gjë e cila i shërben sistemit të ndihmës juridike falas sa i përket hartimit të politikave në këtë fushë dhe monitorimit të cilësisë së shërbimit të ofruar në kohë reale.

Për sa i përket këtij projekti, stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas ka zhvilluar takime me përfaqësues të Euralius ku takimi i fundit u zhvillua më datë 08.07.2020. Në vija të përgjithshme, qëllimi i këtij takimi konsistonte në mënyrën se si do të do të funksionojë CMS në terma konkretë. Duke qenë se Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas nuk ka kapacitet për implementimin e këtij sistemi me buxhetin e shtetit, nga ana e ekspertëve të Euralius u sugjerua që të vijohet me mbështetjen nga Euralius hap pas hapi duke krijuar si fillim një sistem i cili do të shërbejë për stafin e Drejtorisë dhe në vijim do të avancohet me përfshirjen e aktorëve të tjerë (përmendim këtu gjykatat, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dhomat vendore të avokatisë).

Në mënyrë që ky projekt të implementohet është i nevojshëm financimi i softëare dhe hardëare (pajisje) si dhe blerja e licencave për personat që do të kenë akses në sistem (pa këto 2 elementë sistemi nuk mund të jetë funksional). Euralius theksoi se ky i fundit do të mbështesë vetëm krijimin (projektimin) e këtij sistemi dhe asistencën sa i përket përdorimit të tij, por nuk financon lidhur me serverin dhe licencat. Një tjetër problematikë në këtë kuadër rezulton edhe kostoja e mirëmbajtjes së këtij sistemi duke marrë në konsideratë faktin se Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas nuk ka të parashikuar specifik për IT apo blerje licencash. Theksojmë se për projekte e reja në fushën e TIK, termat e referencës për çdo projekt duhet të bëhen në bashkëpunim me AKSHI si insitucioni kryesor përgjegjës dhe të miratohen nga ky i fundit.

- **Manual i Ligjit nr.111/2017 dhe akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij**

Një tjetër aktivitet i parashikuar në planin e punës të Euralius në mbështetje të drejtorisë është dhe hartimi i një manuali për Ligjin nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, dhe aktet

nënligjore të miratuara në zbatim të tij. Ky draft manual i është përcjellë drejtorisë, dhe kjo e fundit ka dërguar komentet dhe qëndrimin e saj. Nga takimi i fundit me përfaqësues të Euralius, na u bë më dije se Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas duhet të japë qëndrimin e saj final sa i përket këtij manuali, përpara publikimit të tij.

- **Postera informues në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike falas**

Në funksion të promovimit të sistemit të ndihmës juridike falas, u propozua vendosja e stendave/posterave pranë çdo gjykate të Republikës së Shqipërisë. Në kuadër të mbështetjes së këaj nisme, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas zhvilloi një takim në muajin Maj me përfaqësues të Euralius, u shpreh dakordësia në dizajnimin dhe printimin e 500 posterave me qëllim afishimin e tyre pranë çdo gjykate të Republikës së Shqipërisë.

- Bashkëpunimi me OSFA

Përmes projektit: “Ofrimi i ndihmës juridike parësore falas përmes themelimit të dy Qendrave të Ndhmës Juridike Parësore në Tiranë dhe Elbasan”, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në mbështetje me OSFA është duke administruar 2 qendra të ofrimit të ndihmës juridike parësore në Tiranë dhe Elbasan.

Ky projekt ka si qëllim të kontribuojë në përmirësimin e sistemit të ndihmës juridike falas, veçanërisht në kuadër të ndihmës juridike parësore. Nëpërmjet këtij projekti synohet përmbushja e objektivave të mëposhtëm: Edukimi ligjor i qytetarëve; Sigurimi i shërbimeve ligjore parësore për qytetarët që kërkojnë ndihmë ligjore lidhur me problemet të cilat vijnë kryesisht si pasojë e veprimtarisë së organeve administrative, por edhe çështjeve civile; Rritje e qasjes në drejtësi.

Në kuadër të projektit të sipërcituar, sistemi i ndihmës juridike të garantuar nga shteti tashmë ofrohet edhe në një formë të re (ONLINE) përmes mundësisit të platformës www.juristionline.al dhe numrit pa pagesë 08001010 të cilat kanë rezultuar mjaft të përdorshme nga qytetarët.

Nga ana tjetër, bëjmë me dije se Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas zhvilloi më datë 09.07.2020, një takim me përfaqësues të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë si një nga donatorët dhe bashkëpunuesit e Drejtorisë në kuadër të disa projekteve me qëllim forcimin e aksesit në drejtësi për qytetarët.

Në këtë takim ndër të tjera u diskutua **mbi sistemin elektronik të të dhënave që Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë administron**. Ky sistem është implementuar në Klinikat Ligjore të hapura nga ana e SOROS përmes të cilit administrohen të dhëna për të gjitha shërbimet juridike parësore të ofruara nga këto Klinika. Nga SOROS u theksua gadishmëria dhe bashkëpunimi për ta zhvilluar më tej këtë sistem me synimin për të përfshirë të gjitha të dhënat e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike falas, përcaktuar në ligjin 111/2017.

Përfaqësuesit e SOROS u shprehën se ky sistem është i gatshëm, funksional, lehtësisht i transferueshëm me qëllim aksesimin nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe mbi të gjitha do të financohet në vijimësi nga ana e këtij fondacioni duke mos rënduar buxhetin e Drejtorisë.